



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:094377
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05511704

CN.60/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E. B. nga Gjilani, përfaqësuar nga A. Z., avokat në Gjilan, kundër të paditurës A. B. nga Prizreni, adresa: rr. "V. F.", nr. 132/2, Prizren, objekti i kontestit pagim i borxhit, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës Themelore në Gjilan, në seancën jo publike të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në çështjen e paditëses E. B. nga Gjilani, kundër të paditurës Arta Bajraktari nga Prizreni, është kompetente lëndore dhe territoriale Gjykata Themelore në Gjilan, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, në bazë të aktvendimit C.nr.343/19 datë 24.05.2019, ka vendosur të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur për këtë çështje juridike. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj do të dorëzohet Gjykatës Themelore në Prizren, si gjykatë kompetente, në kompetencë të mëtutjeshme territoriale.

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, nuk e ka pranuar kompetencën territoriale dhe me shkresën C.nr.2124/2019, e datës 29.03.2022, ka hapur konfliktin e kompetencës duke kërkuar nga Gjykata e Apelit që të vendos se cila nga këto dy gjykatat është kompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur në çështjen kontestuese.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të dy Gjykatave, gjeti së kompetente territoriale dhe lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese është Gjykata Themelore në Gjilan.

Gjykata e Apelit duke vendosur në lidhje me konfliktin e kompetencës të shkaktuar në mes të këtyre dy gjykatave, gjen se Gjykata Themelore në Gjilan nuk ka mundur që të shpallet jo kompetente në pikëpamje territoriale në këtë çështje juridike kontestimore pa prapësimin e palës së paditur.

Me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1, i LPK-së përcaktohet se: *”Gjykata mund të shpallët jo kompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtruar me anë të përgjigjes në padi”*.

Në këtë rast Gjykata Themelore në Gjilan në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë, pa ja dhënë mundësinë palës së paditur që të deklarohet lidhur me padinë përkatësisht mundësin për të bërë prapësim lidhur me kompetencën territoriale, jashtë seancës ka vendosur që të shpallët jo kompetente territoriale, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1, të LPK-së. Bazuar në natyrën e kontestit kthim borxhi, LPK i tanishëm në fuqi, nuk mundëson që gjykata zyrtarisht të shpallet inkompetente por vetëm duke vepruar sipas prapësimit të palës së paditur.

Në kuptim të arsyeve të sipër theksuara, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prizren, me të drejtë e ka hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestuese.

Nga të lartë cekurat e në pajtim me dispozitën e nenit 25 paragrafi 1 i LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
CN.60/2022, me datë 27.03.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli